



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 953 / Prot.

Patos më 22 .04.2024.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 16.04.2024

I mbajtur sot më datë 16.04.2024 në orën 11:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë :

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltarë:

1. Armand Ahmetaj
2. Klaudio Alisinanaj
3. Erald Çepele
4. Artan Velçani
5. Smerald Hazizaj
6. Vjollca Kasaj
7. Albiona Lamaj
8. Ertilla Myrtaj
9. Lori Musaj
10. Novrus Toska
11. Elmira Rama
12. Zejni Musaj
13. Liljana Mesutaj
14. Eduart Faslliaj
15. Renaldo Shpata

Pasi verifikohet kuorumi i mbledhjes i cili plotëson 50 %+ 1 këshilltar kalohet në miratimin e rendit të ditës i cili është si më poshtë:

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.03.2024.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.03.2024.
- 4- Projekt-vendim “Mbi miratimin e shërbimit të transportit publik të linjës Patosi i Ri- Mustafa Matohiti-Margëlliç me mjete transporti të bashkisë, miratimin e vlerës së biletës si tarifë për mbulimin e shërbimit me mjete transporti”.
- 5- Projekt-vendim “Për miratimin e projektit të rikonstruksionit të rrugës “Shën Trifoni” dhe “Shën Sotiri”, Sheqishte”.
- 6- Projekt-vendim “Për miratimin e procesverbalit standard, për efekt të përlogaritjes së sipërfaqes së truallit, ndërtesës dhe hapësirës publike për bizneset në bashkinë Patos”.
- 7- Projekt-vendim “Për miratimin e aktit të themelimit të shoqërisë së trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier nr. 916., prot datë 03.04.2024”.

Takimi hapet nga Kryetari i Këshillit Z.Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj-Kuorumi ligjor i rregullt, gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) këshilltarë.

Përshëndetje të nderuar koleg, këshilltarë, i nderuar Kryetar i Bashkisë, e nderuar deputete !

Zhvillojmë këtë mbledhje jashtë radhe në zbatim të nenit 53 pika 3 gërma a të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, si dhe të nenit 59 të “Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin të Këshillit Bashkiak.

Kjo mbledhje zhvillohet me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë e cila mban numrin 753 prot., datë 08.04.2024

Dua t’ju informoj se janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për hartimin e rendit të ditës, pra mbledhja e kryesisë, shqyrtimi i të gjitha pikave nëpër komisione për të cilat do të kemi një raport nga kryetarët (lexohet rendi ditës i shënuar mësipër).

Para se të kalojmë në votimin e rendit të ditës dua t’ju informoj që nga Kryetari i Bashkisë ka ardhur një kërkesë për të shtuar në rendin e ditës bazuar kjo në nenin 59 pika 7 të rregullores për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak. Do të doja që paraprakisht para se të votojmë rendin e ditës një informacion të shkurtër të kërkesës nga ekzekutivi ose nga Kryetari i Bashkisë. Të lutem Kryetar!

Kryetari i Bashkisë- Përshëndetje! Faleminderit të gjithëve!

Kërkesa shtesë është për përdorimin e fondit të emergjencave civile, dje ju ka ardhur një email, ka një lapus tek pjesa e vlerës, pak më vonë do ta themi dhe fiks sa është sepse duhet ta kontrolloj tek letrat. Është përdorimi i fondit të emergjencave civile, miratimin e përdorimit të fondit dhe miratimin e vendit ku do të përdoret ai si fond. Kur të vij pika do ta saktësojmë më shumë edhe me detaje.

Armand Ahmetaj- Është pikë për tu shtuar në rendin e ditës dhe nëse do të mitatohet do të trajtohet në pikën e fundit.

Kush është dakord me rendin e ditës?

Nëse nuk ka gjë tjetër, atëherë e kalojmë në votim për miratimin e rendit të ditës.

Kundër s’ka, abstenim ska, miratohet me 15 vota pro.

SEKRETARI
Refaela Xeba




Liljana Vesulaj




Edvart Follaj



kelandro Alisimani



KRYETARI
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 953 Prot.

110

Patos më 22 .04.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 16.04.2024 ora 11:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 29.03.2024.

Armand Ahmetaj- Nëse ka ndonjë diskutim, pyetje apo sygjërim për korrigjim procesverbalit?

Eduart Faslliaj- Mesa pash materialet një nga aktet është kthyer.

Armand Ahmetaj- Po do ta japim si informacion.

Eduart Faslliaj- Po atëherë procesverbalit duhet të korrigojë pastaj të miratohet.

Armand Ahmetaj- Jo nuk ka lidhje me këtë është procedurë që ne do ta japim si informacion sepse ajo është ezauruar, është kthyer nga Prefekti.

Si rregull është procesverbalit i cili vërteton gjithë veprimtarinë që ne kemi kryer në mbledhjen e kaluar. Le të themi që e ka kthyer për procedurë Prefektura. Ne duhet të votojmë tanë nëse kemi dakord me çfarë është shkruar në procesverbal. Ka një komision i cili e ka lexuar, e ka nënshkruar.

Nëse ska gje tjetër në bazë të nenit 77 të rregullores e konsiderojmë të miratuar procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

SEKRETARI
Refaela Xeba

Riljana Mesutaj

Eduart Faslliaj

Klaudio Hrisinano

KRYETARI
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 953 / Prot.
111

Patos më, 22 04.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 16.04.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 29.03.2024

Armand Ahmetaj – Të lutem Refaela!

Refaela Xeba , Përshëndetje të gjithëve! Në mbledhjen e datës 29.03.2024 janë marrë gjithsej nëntë vendime nga numri 19 deri në 27, të gjitha vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorisë përkatëse për ekzekutim.

Nga këto 9 vendime vetëm vendimi nr. 23 dhe nr. 24 i është përcjell Prefekturës për verifikim dhe me shkres nr. 760/6.1 datë 12.04.2024 ka ardhur pëgjigja se vendimi nr. 23 kthehet si i pabazuar në VKM -në nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile”.

Ndërsa vendimi nr. 24 ka ardhur në përputhje me ligjin.

Të gjithë materialin, shkresën nga Prefektura unë jua kam nisur me email dje, nëse doni jua rilexoj përsëri.

Erald Çepele- Faleminderit! Lidhur me vendimin nr. 23 të mbledhjes së kaluar për dhënie dëmshpërblim për humbje jete të qytetarit nga fshati Verbas, ne e kemi diskutuar gjatë me Arbenin dhe kemi qënë jo fort dakord lidhur me argumentimin që është bërë atje. Unë do të kërkoja nga ekzekutivi ta rifusim në mbledhjen e ardhshme dhe ne ti japim dëmshpërblimin për humbjen e jetës së qytetarit nga fondet e Bahkisë, se nuk shkon që ne të marim vendime dhe të na kthehen. Unë do kërkoja që herës tjetër të përgatitej materiali dhe brenda mundësive baza ligjore, ta rifusim prap dhe ta dëmshpërblejmë.

Klaudio Alisananaj- Si kryetar i komisionit të ligjeve u njoha me kthim-përgjigjen e institucionit të Prefektit, mendoj ta rifusim këtë përsëri në miratim për ta kaluar fondin e emergjencave për dëmshpërblimin e qytetarit. Në fakt unë e lexova këtë dhe në pyetjen që ka bërë institucioni i Prefektit duke na pyetur se cilat kriterë përcakton plotëson për përdorimin e fondit të kushtëzuar, ajo është e pasqyruar qartë në fakt në gjithë VKM nr.414 datë 08.07.2021 ku është pika 3.1 shkronja “a” duke e cituar në fakt që 60% deri 100% të fondit të dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret për akordimin e ndihmës financiare për familjet banesat e të cilëve janë dëmtuar nga një fatkeqësi natyrore ose nga fatkeqësi të tjera sipas kriterëve specifike të përcaktuara nga aktet nënligjore të ligjit nr.45/2019 për mbrojtjen civile, neni 41.

Duke u bazuar në fakt sipas këtij vendimi tek ligji nr. 45/2019 neni 3, pika 10, është e përcaktuar qartë se te Fatkeqësi të tjera” janë aksidentet teknologjike, rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore ekologjike ose industriale dhe aksidente të tjera të shkaktuara nga veprimi njerëzor, ku edhe këtu mund të përcaktohet rasti në fjalë. Kështu që duke u bazuar përveç kësaj VKM dhe gjithë legjislacionit shqipëtar ku kemi dhe ligje të tjera që kemi përmendur tek miratimi i propozojë këshillit për ta miratuar përsëri dhënien e ndihmës financiare pasi këtu legjislacioni është përdorur i qartë dhe nuk ka nevojë për interpretim. Ta miratojmë përsëri me fondin e emergjencave jo me fondin e Bashkisë.

Albiona Lamaj- Ideja është që në rrugën ligjore në momentin që Prefektura e kthen ne duhet ti drejtohem gjykatës mendoj unë se nuk mund të shkojmë përsëri tek Prefektura me të njejtin arsyetim në momentin që e ka kthyer dhe i bie që ne vonohemi dhe nuk e shpërblejmë ashtu si duhet qytetarin. Kështu që duhet parë ana ligjore nëse kemi mundësi të tjera ligjore që mund ta ndihmojmë atë që tha Eraldi, nga fondet e tjera të Bashkisë.

Eduart Faslliaj- Ndaj të njejtin mendim me Albën që për rastin në fjalë që është anuluar nga Prefektura ai është organi kompetent që kthen aktin. E para njëherë institucioni që ka sjell aktin duhet të ketë përgjegjësinë për formulimin gabim nga ana ligjore dhe e dyta në qoftë se kërkojmë të marim një rezultat tjetër me të njejtat kushte është gabim i joni i përsëritur. Dua të them- që ne nuk mund ti drejtohem me të njejtin arsyetim Prefekturës sepse do të kemi të njëjtën përgjigje. Unë ju falenderoj por e shikoj si një përplasje institucionesh midis Bashkisë dhe Prefekturës. Deri sa Prefektura rekomandon dhe thotë se ju duhet ta trajtoni në këtë formë kur është kompetencë e këtij institucioni. Më vjen keq që jeni përplasur këto debate.

Mos u lodhni kot për të njejtin akt sepse mendoj se jeni duke u tallur me fatkeqësinë e tij. Kërkoj një mënyrë tjetër për ta zgjidhur gjënë. Dhe hërë tjetër mos na e sillni të paparë nga ana juridike.

Armand Ahmetaj- S’ mund të themi tallje sepse gjithë këshilli ishte i angazhuar që ne të bënim diçka për rastin në fjalë, megjithatë përplasje ligjore ka kudo. Do të ndërmarim të gjitha hapat proceduriale për ti dhënë zgjidhje.


Kryetari i Bashkisë- Për pjesën e dëmshpërblimit që të vemi në Prefekturë me të njejtin argument nuk bëhet, sepse nuk bëhet i njejtin veprim dhe të presim rezultat tjetër. Po bëre të njejtin veprim të njejtin rezultat do marrësh prap. Kështu që do shikojmë bazën ligjore çfarë mund të bëjmë dhe e kalojmë në këshill përsëri. Mbase që këtë muaj ose dhe më vonë por do parë njëherë baza ligjore dhe dëmshpërblimi.

Erald Çepele- Unë kam qënë i dyzuar që në vendimin e parë lidhur me këtë pjesë se VKM nr. 414 e thotë për fatkeqësi natyrore dhe të tjera.

Fatkeqësi natyrore janë përmbytjet, tërmetet dhe zjarret por të tjera janë përdorimi i armeve bërthamore dhe të tjera por jo humbjes njerëzore nga një zjarr kështu që bie poshte.

Armand Ahmetaj- Do ta shohim hap pas hapi procedurën dhe do jemi në kontakt për këtë pjesë.

SEKRETARI
Refaela Xeba



KRYETARI
Armand Ahmetaj



Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 554 Prot.
18

Patos më 22.04.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 16.04.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt- vendim “Mbi miratimin e shërbimit të transportit publik të linjës Patosi i Ri- Mustafa Matohiti-Margëlliç me mjete transporti të bashkisë, miratimin e vlerës së biletës si tarifë për mbulimin e shërbimit me mjete transporti”.

Armand Ahmetaj- Është një problem i rëndësishëm që ka kohë në Bashkinë tonë ndaj do t’ju lutesha të jemi më aktiv në këtë pjesë. Së pari dua fjalën e komisionit të shërbimeve i cili e ka marrë në shqyrtim.

Artan Velçani -Kryetar i komisionit të Shërbimeve Publike, Zhvillimi Urban, Ndërtimet dhe Pronat.

Atëherë komisioni i Shërbimeve Publike, Zhvillimi Urban, Ndërtimet dhe Pronat e mori në konsiderat projektvendimin e sjell dhe pasi bëri konsultën me ekzekutivin në raport me argumentimin në përputhje me ligjin e pa të arsyeshme ta miratojë atë dhe ta sjell sot për miratim.

Atëherë përfaqësuesi i ekzekutivit të relatoi në lidhje me këtë pikë.

Mimoza Shtëmari – Drejtore e Financës dhe Shërbimit Social- Përshëndetje të gjithëve!
Ashtu si dhe ju të gjithë si këshillë keni qënë në dëgjesën publike që u bë me objekt vetëm për zgjidhjen e situatës për linjën e transportit në Patosi i Ri- Mustafa Matohiti-Margëlliç. Në bazë të ligjeve që janë në fuqi ne kemi hartuar projektvendimin dhe gjithashtu dhe dakrordësia që u bë me qytetarët e këtij komuniteti dhe në bazë të ligjit këshilli ka kompetencë kur nuk është e zgjidhur ndryshe në akte ligjore dhe nënligjore të zgjidh shërbime publike në favor të komunitetit. Për këtë ne kemi hartuar projektvendimin dhe kërkojmë:

Të miratojë shërbimin e transportit publik për linjën Patos i Ri-Mustafa Matohiti-Margëlliç me mjete transporti nga Bashkia.

Nisur nga dakordësia të miratojë tarifën e biletës prej 50 lekë për mbulimin e transportit dhe karburantit.

Gjithashtu i kërkojmë këshillit të vendosë dhe të miratojë oraret e transportit për çdo ditë.

Kryetari i Bashkisë - Kjo është një problematikë që ka filluar që nga janari, ne patëm kontakt dhe me persona fizik dhe me kompani që ushtronin këtë lloj aktiviteti dhe asnjë nuk ishte i gatshëm për ta pranuar për linjën Patos i Vjetër -Mustafa Matohiti dhe në muajin mars ka ardhur një kërkesë nga banorët nga 256 qytetarë që kërkojnë zgjidhjen e problematikës së linjës së transportit Patos-Lart. Duke marrë shkas nga gjithë kjo gjë ne jemi para faktit se do ta vendosim vet si linjë transporti me mjetet e bashkisë një furgon edhe autobuz. Do ketë dhe dy shofera. Rrogat e shoferëve, karburanti, mjeti, serviset e makinave besoj se nga çmimi është e mjaftueshme për mbulimin e gjithë koston. Nëse do ketë fitim ngelet për të diskutuar.

Pjesa e orareve ngelet për të diskutuar dhe ndarë sot me ju, ndërsa për të ardhmen duke parë si do jetë linja do shohim shtimin ose heqjen e orareve të caktuara, por dhe këto do ti diskutojmë bashkë përsëri. Faleminderit!

Smerald Hazizaj- Unë si një nga qytetarët e zonës së lagjes Mustafa Matohiti njëkohësisht duke parë afërsinë e Patosit të Vjetër, të Margëllicit dhe Rerësit shpreh falenderimet e mia që zeri i qytetarëve është marrë në konsideratë dhe padiskutim po shkojmë drejt një zgjidhje përfundimtare pas katër muajëve për të cilën ky shërbim realisht ka munguar në atë zonë dhe normalisht ka rënduar në xhepat e qytetarëve. Më lejoni të them që ky është një transport publik që u shërben më tepër se 4000(katër mijë) banorëve. Sot jemi përball faktit që kjo linjë po shkon drejt përfundimit. Mendoj që oraret të jenë fikse, të paktën mëngjesi të jetë cik i shpeshtë. Ora 06:15 e mëngjesit duhet të jetë një nga oraret që punonjësit të kapin të gjithë punën.

Kryetari i Bashkisë - ora 06:15 nga Patosi apo që nga Patosi Vjetër?

Smerald Hazizaj- 06:15 të jetë nisja nga Patosi Vjetër ose Margëllici dhe çdo 30 min është e mjaftueshme të paktën deri në orën nëntë pasi është pikë për të lëvizur.

Eduart Faslliaj- Më së pari unë kisha dy pyetje për ekzekutivin. Do filloj me një mjet apo do filloj me dy mjete? Dhe kur do jetë dita e parë?

Kryetari i Bashkisë- Dita e parë do të jetë pasi të vij dhe miratimi nga ana e Prefekturës, ditën tjetër besoj do vendoset linja. Do jetë një mjet, janë dy por në varësi të situatës. Kishim për të vendosur autobuzin por e hoqëm, do vendosim furgonin, kjo për efekt orari për të kapur orarin në mëngjes pasi autobuzi që të niset nga Patosi lart të vij poshtë do 15(pesëmbëdhjetë) min, ndërsa për të vajtur në Patos lart do gjysmë ore.

Eduart Faslliaj- Mblidhemi një herë për këtë punë dhe vendosim përfundimisht sepse ky do të jetë një akt i miratuar për këtë lloj problematike, për ti dhënë zgjidhje. Në rastin kur ne nuk i specifikojmë gjërat sigurisht ngelen të pa miratuara. Kjo pastaj ka vënd për të interpretuar sepse ne nuk dimë çfarë jemi duke bërë. Pyeta kur do fillonte sepse po shkon pesë muaj pa shërbim dhe kostoja qytetarëve u ka rënduar.

Dua të di për mjetin sepse nëse na duhet të marim mjet tjetër duhet të marim shofer tjetër sipas procedurës ligjore do na duhet të miratojmë edhe personel plus në organikën e bashkisë. Pyeta për llojin e mjetit sepse unë e di fluksin e levizjes për të parë a e përballon dot fluksin. Meqënëse këtë po e mer Bashkia dhe në momentin që e mer Bashkia përveç tarifës që vendosim që mendojmë se mbulon pjesën më të madhe të kostove ne kemi problematikë shumë të madhe lëvizjen e nxënësve dhe në qoftë se nxënësit do t'ju duhet të paguajnë bileta rriten kostot për familjen dhe ligji nuk i lejon mesa di unë që të paguajnë.

Mimoza Shtëmbari- Është për ZVA-në pjesa e nxënësve.

Eduart Faslliaj- Në rregull nëse ata kompesohen. Pyeta për kapacitetin e mjetit se në kohën që lëvizin mesuesit dhe nxënësit na duhet një mjet me kapacitet të madh për ti përballuar dhe do detyrohen të rrinë në këmbë. Dhe po bie dakord po prap për problematikën që autobuzi është mjet me kapacitet të madh po humbet në kohë dhe ne nuk kapim dot ritmin e kohës. Megjithatë ngela i sqaruar, këto janë hapësirat që ju pyeta juve. Tani dua të them dy fjalë meqënëse jam këtu besoj se do ma jepni kohën. Jam shumë dakort dhe mbetet për të falenderuar puna e ekzekutivit për ti dhënë zgjidhje këtij problemi por mënyra se si u veprua për ti dhënë zgjidhje problemit për mua është më shumë politike sesa funksionale. Që nga momenti i mbledhjes së firmave që nuk e dimë se kush e organizojë? Se ku shkuan 250 firma? Se kush ishte ekipi që i mblodhi? Nga ana ligjore kur organizohet një dëgjese publike shpallja vendoset në qendër të lagjes që banorët e lagjes të marin vesh, të kenë informacionin e duhur që çfarë po ndodh. Fakti që ju organizuat nëpërmjet kryetarëve të fshatrave që paguhen nga ekzekutivi, sekretarëve të partisë, patronazhistëve dhe gjithë pjesëmarrja atje 80% apo 90% ishte e pjesës tuaj politike unë besoj se gjithë kjo punë u bë një show

i madh për ti dhënë suport partisë në pushtet nëpërmjet parave të taksapaguesve të lagjes dhe zonës. Dhe kjo nuk është hiç e drejtë por nuk është dhe ligjore.

Unë falenderimin e bëra dhe publik atë ditë, ishte hera e parë që ne shikonim që një Kryetar Bashkie vjen dhe ulet me komunitetin për problematikat të përditshmërisë së tyre por mënyra se si u organizua, benefitet që doni të merni nga ai takim që më shumë se dëgjese publike ishte zhurmë publike.

Edhe aty ku e kishit organizuar e kishit bërë me hile se e kishit organizuar në një ambient për mos të dëgjuar fare zërin e qytetarëve dhe ne dolëm nga aty pa marrë problematikat sepse atje nuk dëgjohej asnjë gje. Dhe meqënëse nuk i morëm dhe ju keni shkruar aty vetëm katër problematika unë dua t'ju kujtoj se lagja ka dhe problematika të tjera. Lagja Mustafa Matohit është e shpërndarë, kemi një pjesë të lagjes që quhet "Menza Tre". Zona jonë ka qënë tradicionalisht zona ku hidheshin mbeturinat urbane të Bashkisë. Ishin në Rerës fillimisht pastaj shkuan në "Menza Tre" domethënë jemi përdorur si vend depozitim mbetjesh dhe për këtë arsye ekzekutivi i është borxhlie atij komuniteti atje. Atij komuniteti që e keni lënë pa zhvillim mjekësor, madje as infermier ska. Ajo pjesa "Menza Tre" që hidheshin mbeturinat dhe është përpjekur pjesërisht është arritur rehabilitimi, nuk e mohojmë dot këtë ka nevojë për një ndriçim. Ne e kemi të parashikuar nga buxheti për 60 ndriçues për atë zonën atje, mesa mbaj mend dhe unë do të doja që ajo pjesë e rrugës që lidh lagjen "Mustafa Matohiti" që kalon nga "Menza Tre" deri ku janë dhe banorët dhe taksapages njëkohësisht, që paguajë dhe tarifën e ndriçimit të plotësohet me ndriçues sepse ajo shërben dhe si një zonë që njerëzit lëvizin në këmbë. Keni nisur një lulishte aty në qendër që hodhët katër sheshe për stolat dhe nuk u arrit asnjëherë.

Kryetari i Bashkisë- Tani për pjesën e dëgjësës që the që janë vetëm katër problematika, dëgjesa nuk ishte për problematika, dëgjesa u bë vetëm për linjën e transportit pavarësisht të tjerave dëgjesa ka qënë vetëm për linjën. Atje kishte më shumë njerëz se ç'kishte votues për partinë që ti nuk e pëlqen. Palestra e shkollës kishte më shumë qytetar sesa votues. Ti ishe dhe vet.

Për pjesën e ndriçuesave nuk janë bërë akoma si procedurë. Duke ditur që procedurat që të bëhen duhet të jenë lekët tek buxheti bashkisë, të jenë gjendje ato lekët. Është parashikuar por jo koha kur do të bëhet. Por është e sigurt që do bëhet.

Armand Ahmetaj-Më lini t'ju jepja një përgjigje për ligjeratën. Ti the që ishte thellësisht politike dhe mirë bën por nuk besoj se je në rrugën e duhur por teknike dhe ligjore aspak. Ti si këshilltarë duhet ta njohësh mirë rregulloren pra dëgjesat, ne mund ti organizojmë dhe vet e cila në këtë rast ishte e organizuar nga bashkia e bazuar ne Rregullore si për datën, orën, vendin e njoftimit.

Eduart Faslliaj- Unë jam konsultuar me grupet e interesit të zonës dhe kam nxjerr një orar të parashikuar sipas fluksit të lëvizjes.

Në 06:15 mjeti të nisët nga lart dhe fluski levizjes çdo gjysmë ore të jetë nga ora 06:00 deri në orën 09:30.

Pastaj nga ora 09:30 deri në 12:00 të jetë çdo dy ore. Ndërsa nga ora 12:00 deri në 14:00 unë mendoj se duhet të shkoj deri në Margjëllic. Fasha e orarit të jetë çdo 30 minuta nga ora 12:00 deri në orën 15:00 dhe të përfundojë në orën 19:00 nga Patosi dhe në 19:15 nga Patosi Vjetër të jetë orari i fundit në orën 19:15.

Zejni Musaj- Firmat tona kanë punëtor në këto zona. Oraret janë në 07:00 me 15:30. Autobuzi të jetë në 06:30 nga Patosi Vjetër. Janë rreth 10(dhjetë) punëtor. Po të ketë mundësi të bëhët një stacion tek fusha e sportit.

Të rishikohet dhe orari 15:30.

Smerald Hazizaj - Të gjithë ata që morën pjesë në dëgjese publike janë qytetarë pa asnjë lloj diskriminimi të Mustafa Matohiti.

Erald Çepele- Në orën 07:30 duhet të ketë një këmbim të dy linjave. Dhe në 13:45 përsëri. Nëse do jenë dy mjete më mirë akoma. Nisja në 06:30 e mëngjesit me 18:30.

Smerald Hazizaj- orari i fundit i nisjes të jetë nga Patosi për tu ngjitur lart. 06:15 mendoj se është i mjaftueshëm për mbyllje.

Klaudio Alisananja- Mendoj ta fillojmë si orar 06:00 me 18:00 pastaj e rishikojmë përsëri.

Kryetar i Bashkisë- Nga ora 06:00 deri në 08:30 do jetë çdo 30 min nga një statcion. Do jetë një mjet dhe dy shofera.

Ideja e orarit- Fillojmë në 06:00 deri në 09:00 do jetë çdo 30 min. Tjetri do jetë në 10:30 + 1 orë e 30 shkon 12:30. Pastaj 13: 00, 13:30, 14:00.

Pastaj nga ora 15:30 deri në 16:30 çdo gjysmë ore. Dhe në orën 18:00 do jetë mbyllja e orarit.

Nëse furgoni shkon çdo gjysmë ore me dy ose tre persona ne nuk e mbulojmë dot koston. Nëse do ketë më shumë njerëz ne do ti shtojmë mjetët. Do vendosim dy mjete dy shofera. Për pjesën që kërkoj z. Zejri Musaj nuk mund të bëhet.

Armand Ahmetaj- Kryetar ju lutem ta përmendim dhe një herë orarin për efekt regjistrimi dhe pastaj e hedhim në votim.

Kryetar i Bashkisë- Orari duke filluar nga ora 06:00 deri në 09:00 do jetë çdo 30 min në Patos dhe çdo 30 min në lagjen Mustafa Matohiti. Pastaj do vazhdojë çdo 1 orë e 30 min deri në 12:30 pastaj nga ora 12:30 do jetë çdo 30 min deri në orën 14:00. Dhe nga ora 16:00 deri në 17:30 do jetë çdo gjysmë ore.

Keni ndonjë diskutim tjetër para se të kalojmë në votim? Atëherë kalojmë në votimin e pikës së katërt Projekt- vendim “Mbi miratimin e shërbimit të transportit publik të linjës Patosi i Ri- Mustafa Matohiti-Margëlliç me mjete transporti të bashkisë, miratimin e vlerës së biletës si tarifë për mbulimin e shërbimit me mjete transporti” sipas propozimit të kryetrit të Bashkisë.

Kush është dakord?

15 vota pro, abstenim ska, kundër ska, miratohet.

SEKRETARI


Refaela Xeba



Rijana Mesutaj


KRYETARI

Armand Ahmetaj



Ednort Forllias

Klaudio Alsinonaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3328 Prot.
16

Patos më 22 04.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 16.04.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt- vendim “Për miratimin e projektit të rikonstruksionit të rrugës “Shën Trifoni” dhe “Shën Sotiri”, Sheqishte”.

Armand Ahmetaj - I lutem kryetarit të komisionit të Shërbimeve!
Komisioni u mbledh ditën e djeshme dhe vendosi ta miratojë atë.

Ekzekutivi (Ermenita Mici)- relaton materialin.

Novrus Toska- Mendoj se duket si projekt i fryrë në kosto.

Ermenita Mici- Kur fillon një projekt për rikonstruksionin e rrugës kemi parasysh dhe llojin e rrugës dhe fluksin e automjeteve që do të kalojnë, çka do të thotë që ajo rrugë do ti shërbejë banorëve të zonës dhe atyre besimatarëve të cilët duan të frekuentojnë këta dy objekte. Nga ana teknike ne e kemi menduar të arsyeshme atë gjerësi. Punimet konsistojnë në shtrimin me asfalt dhe shtresa të tjera plotësuese.

Novrus Toska- Bankersi punon me projekte të fryra, justifikon paret e tij , ne duhet ta shikojmë këtë pjesë.

Kryetari Bashkisë. Janë 2562 m² që do të trajtohen me të gjitha shtresat për të shtruar rrugë. 2500 m² çakull me një trashësi të caktuar, vazhdon me stabilizantë me trashësi të caktuar 7 cm, pastaj vazhdon me binter që ka një trashësi të caktuar. Është dhe shtresa e asfaltit 4 ose 5 cm. Të gjitha këto i ke 2556 m² shumëzim për një çmim që është çmim i manualit i vendosur nga qeveria i cili ndryshon çdo muaj. Data kur është projekti, preventimi meret nga e-albania. Dhe preventivin nuk e ka bërë Bankersi por e ka bërë Bashkia. Janë çmime standarte, nuk lëviz dot.

Elmira Rama- Ky projekt është vendim është i duhur, shpresoj të hap rrugë dhe për investime të tjera.

Kryetari Bashkisë- Kemi parashikuar dhe mbjelljen e pemeve që janë karakteristike e zonës në dy anët e rrugës.

Erald Çepele- Duke qënë se vlera është fikse unë do kërkoja një gjë tjetër duhet pasur parasysh të krijohen xhepa.

Kryetari Bashkisë- Krijimi i xhepave varet nga rrugët. Nuk është e mundur sepse është pak e vështirë se i bie të zvogëlosh disa rrugë.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër para se të kalojmë në votim? Atëherë kalojmë në votimin e pikës së pestë projekt- vendim “Për miratimin e projektit të rikonstruksionit të rrugës “Shën Trifoni” dhe “Shën Sotiri”, Sheqishte”. Kush është dakord?

15 vota pro, abstenim ska , kundër ska, miratohet.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI
Armand Ahmetaj

Adresa: Lagja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”, Patos



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 903/14 / Prot.

Patos më 22 .04.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 16.04.2024 ora 11:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e procesverbalit standard, për efekt të përlllogaritjes së sipërfaqes së truallit, ndërtesës dhe hapësirës publike për bizneset në bashkinë Patos”.

Armand Ahmetaj - I lutem Komisionit!

Lori Musaj- Komisioni e ka votuar me katër vota pro pa asnje ndryshim.

Ekzekutivi (Nurkë Hazizaj) relaton materialin e paraqitur me shkrim.

Erald Cepele- Ky është i njejti procesverbal nga vitet e kaluara apo ka pësuar ndryshim?

Nurkë Hazizaj- Kjo procedurë nuk është se ka ndodhur më parë.

Renaldo Shpata- Deri më sot si janë marrë këto të dhëna?

Nurkë Hazizaj- Këto të dhëna janë marrë nga certifikatat e pronësisë që vet bizneset kanë deklaruar ose nëpërmjet deklarimeve.

Erald Çepele- Biznesi mund të jetë 100 m² por në fakt ai mund të përdori vetëm 30 m². Duhet të ketë një kategorizim.

Kryetari i Bashkisë - Duke filluar nga viti i ardhshëm gjithë transfertat e qeverisë do varet se sa bashki do mbledhin taksën e ndërtesës. Në rast se kjo nuk mblidhet transfertat do ulet. Është një riveifikim i sipërfaqeve.

Eduart Faslliaj- Bizneset e vogla janë në kushtet e mbijetesës, do mbyllen.

Kryetari i Bashkisë- Pjesa më e madhe e kishin pjesën e sipërfaqes 100% të rregullt. Ishin reale.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër para se të kalojmë në votim? Atëherë kalojmë në votimin e pikës së gjashtë projekt-vendim “Për miratimin e procesverbalit standard, për efekt të përlllogaritjes së sipërfaqes së truallit, ndërtesës dhe hapësirës publike për bizneset në bashkinë Patos” Kush është dakord?

15 vota pro, abstenim ska , kundër ska, miratohet.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 916/14 Prot.

Patos më 22 .04.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 16.04.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e aktit të themelimit të shoqërisë të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier nr. 916., prot datë 03.04.2024".

Armand Ahmetaj - I lutem Komisionit

Klaudio Alisananaj – Komisioni u mbledh ditën e hënë në orën 14:00 dhe e miratoi me katër vota pro.

Armand Ahmetaj - I lutem ekzekutivit!

Nurka Hazizaj -Relaton materialin e paraqitur me shkrim.

I kërkojmë këshillit të bashkisë miratimin e aktit të themelimit nr. 917 prot., datë 03.04.2024 dhe statutit të shoqërisë së trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier sh.a, nr. 916 prot., datë 03.04.2024, bashkëlidhur dhe pjesë përberëse e këtij projektvendimi. Dua të bëj një saktësim pasi në projektvendim nuk është parashikuar numri i protokollit të aktit të themelimit gjë që dua të reflektohet në procesverbal dhe kur të zbardhet vendimi të parashikohet në mënyrë që të jetë më e saktë.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Finacës dhe Shërbimit Social, Zv. Kryetarët e Bashkisë dhe Sektori Juridik.

Klaudio Alisananaj- Sa përfaqësues janë? Sa na takojnë?

Kryetari i Bashkisë- Në bordin drejtues është nga një nga secila bashki. Bashkia e Fierit ka dy.

Nurka Hazizaj- Statuti dhe akti themelimit do të zgjasi për aq kohë sa shoqëria do të jetë funksionale.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër para se të kalojmë në votim? Atëherë kalojmë në votimin e pikës së shtatë projekt-vendim "Për miratimin e aktit të themelimit të shoqërisë të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut Fier nr. 916., prot datë 03.04.2024".

Kush është dakord?

15 vota pro, abstenim ska, kundër ska, miratohet.

SEKRETARI
Refaela Xeba

KRYETARI
Armand Ahmetaj

Adresa: Lagja "Naftëtari", Rruga "Unaza", Patos



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1028 Prot.

3

Patos më 22.04.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 16.04.2024 ora 11:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Armand Ahmetaj- Pika tetë e rendit të ditës është pika e cila e miratuar për ta shtuar ne rendin e ditës, projekt-vendimi nr. 33 datë 15.04.2024 të cilën do ta relatoi ekzekutivi.

Ekzekutivi (Arben Shpërdheja) relaton- Përshëndetje të gjithëve!

Projekt-vendim "Mbi miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar me vlerë 4,955,981.29 lekë për mbrojtjen civile, përdorimit të fondit të pakushtëzuar sektorial me vlerë 2,708,931 lekë për mbrojtjen civile, për rehabilitimin e pjesshëm të përroit në lagjen "e Re".

Në mbështetje të nenit 64 shkronja "c", nenit 54, shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", pika 3.1 shkronja "dh", "e", "f", "g", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" i ndryshuar, Ekipi i menaxhimit të mbrojtjes civile duke parë situatën në të cilën ndodhet pozicioni i përroit në lagjen "e Re", i cili grumbullon në shtratin e tij ujërat e një sipërfaqeje të konsiderueshme duke përfshirë nga lagja "Mustafa Matohiti", fshati Rerës, fshati Banaj, fshati Dukas dhe një pjesë të lagjes së Re, krijon probleme në kalueshmërinë e rrugëve kryesore në këto zona. Me qëllim parandalimin e përmytjeve të banesave që ndodhen në përgjatë shtratit të këtij përroi, kërkohet pjesërisht veshja me beton e kanalit dhe pjesërisht mbyllja e kanalit me tuba betoni, duke u dhënë zgjidhje problemit për rreth 60 familje.

Fondi me vlerë 4,955,981.29 (katër milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë njëzetë e nëntë) lekë do të investohet për realizimin e këtij projekti.

Fondi i pakushtëzuar i buxhetit të shtetit për vitin 2024 për mbrojtjen civile në totalin e vet për Bashkinë Patos ka vlerën 5,216,822.41 (pesë milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzetë e dy pikë dyzetë e një) lekë. Me shkresën nr. 539/1 prot., datë 23/02/2024 drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes "Kthim përgjigje për ndarje fondi", Bashkia Patos ka bërë ndarjen si më poshtë:

Kodi i produktit 91707 AG "Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese" është 4,955,981.29 (katër milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë njëzetë e nëntë) lekë,

Kodi i produktit 91707 AB "Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme" është 260,841.12 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind e dyzetë e një pikë dymbëdhjetë).

Kërkojmë nga KB miratimin për përdorimin e këtij fondi.

Vlera e projektit në total shkon 7,664,912.74 lekë ku vlera prej 4,955,981 do të mbulohet nga transfertat e kushtëzuar dhe 2,708,931 lekë nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale e planifikuar në buxhetin e vitin 2024 për mbrojtjen civile. Në këtë vlerë përfshihet dhe mbikqyrje + kolaudimin e objektit sipas preventivit.

Kryetari i Bashkisë- Bëhet fjalë tek lagja e Re tek pjesa e përroit, nga ura e parë deri tek ura e dytë që është tek cirku, kanali do të jëtë i veshur me beton. Pjesa nga ura deri tek fusha do jetë i mbuluar. Pse u arrit në këtë konkluzion?

Duke qënë se atje do filloj rruga besoj shumë shpejt është në fazat e fundit të vlerësimit lind e detyrueshme nga ana jonë dhe përroi pasi dhe vet përroi do jetë e pamundur për tu pastruar por përveç kësaj ne ndërhyjmë për ta pastuar pasi kishte shumë vite pa u pastruar dhe në vende të caktuar ai përriu doli shume i madh dhe ka rrezikshmëri ndaj ajo pjesë do të mbulohet dhe pjesa tjetër do të bëhet me beton. Pjesa që do të mbyllet është e detyrueshme për efekt sigurie. Edhe KUZ është parashikuar. Këtu ku do bëhet ky kanal paralel me këtë është dhe KUZ, do jetë komplet e re për lagjen e Re.

Albiona Lamaj- Është e vërtet përroi përbën edhe probleme shëndetësore.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë diskutim tjetër para se të kalojmë në votim? Atëherë kalojmë në votimin e pikës së tetë projekt-vendim "Mbi miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar me vlerë 4,955,981.29 lekë për mbrojtjen civile, përdorimit të fondit të pakushtëzuar sektorial me vlerë 2,708,931 lekë për mbrojtjen civile, për rehabilitimin e pjesshëm të përroit në lagjen "e Re". Kush është dakord?

15 vota pro, abstenim ska , kundër ska, miratohet.

SEKRETARI
Refaela Xeba



Rijona Acutej



Eduart Folliev



Klaudio Alisinonaj



KRYETARI
Armand Ahmetaj

